

## Studimet krahasuese mbi efektet e komisioneve mbi të vërtetën Përmbledhje

Bogdan Ivanisheviq  
Maj, 2009

Ky tekst është përmbledhja e rezultateve nga studimet e gjëra të autorit të njëjtë, konsultant i Qendrës Ndërkombëtare për të drejtën tranzicionale nga vendet e ish-Jugosllavisë. Përmbledhja si dhe studimi në tërësi kanë për qëllim që në formë të përmbledhur, të ofrojnë informata të sistematizuara për të arriturat e dymbëdhjetë komisioneve më të njohura nga fushat e përcaktimit të së vërtetës, reparacionit, ndjekjeve penale, kërkimin e të zhdukurve dhe reformave institucionale. Qëllimi i tyre nuk është që të parashtrijnë studimin definitiv dhe gjithëpërfshirës, i cili kishte për të paraqitur pozicionimin dhe qasjen e Qendrës ndërkombëtare për të drejtën tranzicionale.

### Hyrje

Hulumtimi është ndërmarrë në fillim të vitit 2009, si përgjigje në kërkesën e koalicionit rajonal të organizatave joqeveritare, e cila përfaqëson vendosjen e komisionit multilateral për përcaktimin e fakteve dhe tregimin e të vërtetës mbi krimet e luftës, të kryera në ish-Jugosllavinë, në mes të viteve 1991 dhe 2001. Lista e komisioneve të cilat janë të përfshira në këtë përmbledhje dhe studim janë:

Vendi	Emri i komisionit	Periudha e punës së komisionit	Periudha e përfshirë me mandat
Argjentina	Komisioni nacional mbi të zhdukurit (CONADEP)	1983-1984	1976-1983
Kili	Komisioni nacional për të vërtetën dhe pajtimin (Komisioni <i>Rettig</i> )	1990-1991	1973-1990
	Komisioni nacional mbi burgosjet politike dhe torturat (Komisioni <i>Valech</i> )	2003-2004	1973-1990

El Salvadori	Komisioni mbi të vërtetën në El Salvador	1992-1993	1980-1992
Gana	Komisioni nacional për pajtim (NRC)	2002-2004	1957-1993
Guatemala	Komisioni për sqarime historike (CEH)	1994-1999	1958-1994
Marok	Komisioni për drejtësi dhe pajtim (IER)	2004-2005	1956-1999
Peru	Komisioni për të vërtetën dhe pajtimin (CVR)	2001-2003	1980-2000
Sierra Leone	Komisioni për të vërtetën dhe pajtimin në Sierra Leone	2002-2004	1991-2000
Afrika Jugore	Komisioni për të vërtetën dhe pajtimin (TRC)	1995-2003	1960-1994
Timori Lindor	Komisioni për të vërtetën, pajtimin dhe pranimin (CAVR)	2002-2005	1974-1999
Timori Lindor & Indonezia	Komisioni për të vërtetën dhe miqësinë (CTF)	2005-2008	1999

Ekzistojnë dy grupe kufizimesh, të cilat e vështirësojnë vlerësimin e efekteve të komisioneve mbi të vërtetën. E para, shpeshherë është e vështirë të përcaktohet lidhja shkak-pasojë mes punës së komisionit dhe ndryshimeve që kanë pasuar në lëmit, siç janë gjykimet, reformat institucionale dhe pajtimet. E dyta, vlerësimi i asaj që paraqet “përparim” në cilën do fushë, mund të jetë shumë subjektive. Bile edhe aty ku ndryshimet mund të paraqiten me numra, rrallëherë mundet që në bazë të atyre numrave-numrave të individëve që marrin reparacionet, rastet e zbardhura të të zhdukurve, gjykimeve, e tjera, të vërtetohet qartë se a paraqesin sukses apo jo. Nuk ekzistojnë kritere të vendosura mirë dhe drejtë për vlerësimin e të arriturave të komisioneve mbi të vërtetën.

Duke pasur parasysh të gjitha këto, prapëseprapë mund të thuhet se komisionet më të njohura mbi të vërtetën, kanë pasur efekte pozitive në ato vende ku kanë funksionuar. Në pesëmbëdhjetë vitet e fundit, komisionet mbi të vërtetën, çdo herë e më shumë kanë ofruar **platformë publike viktimave** të shkeljeve të të drejtave njerëzore, në mënyrë që ato të tregojnë tregimet e tyre. Shumica e analistëve pajtohen me atë se të dëshmuarit publik kanë pasur efekt të madh në kthimin e dinjitetit të viktimave, nxitjen e solidaritetit në kategoritë e gjëra shoqërore, si dhe në nxitjen e debateve më të gjëra mbi çështjet të cilat më parë kanë qenë të përjashtuara nga sferat publike.

Për dëshmimin publik para komisionit Jugo-Afrikën për të vërtetën dhe pajtimin, flitet si për një dëshmi, pas të cilës askush, asnjëherë, nuk ka mundur të mohoj krimet nga e kaluara e atij kombi. Vlerësime të ngjashme janë përcjell edhe për dëshmitë publike në Maroko, Peru edhe në vende tjera. Në fakt, dëshmitë publike u bënë burimi kryesor i fuqisë së komisioneve për të vërtetën, dhe arsyeja kyçe për rritjen e numrit të komisioneve. Mirëpo, ky studim nuk e përfshinë kapitullin mbi efektet e dëshmimeve publike, sepse është i drejtuar nga efektet, në ato forma ku është më lehtë të maten. Nuk

ka shumë hulumtime empirike të efekteve të dëshimit publik në vetë pjesëmarrësit si dhe në shoqërinë, në përgjithësi.

Edhe pse mandatet e shumë komisioneve e përfshijnë “*pajtimin*”, kjo analizë nuk do ta ketë kapitullin mbi efektet e mundshme të komisioneve për të vërtetën dhe pajtimin.<sup>1</sup>

Çfarëdo vlerësimi tjetër i të arriturave të komisioneve mbi të vërtetën, nuk do të guxonin të anashkallonin rëndësinë e faktorit kohë. Përparimi në ndjekjet penale, si dhe përparimi në lëmit tjera, ndonjëherë vije shumë vite pasi që komisioni e ka kryer punën e vet. Prandaj përparimi kërkon angazhimin shumë vjeçar të shoqërisë civile dhe elitës politike. Shembujt e Argjentinës dhe Kilit, të cilët sipas disa indikatorëve paraqesin përvojën pozitive me komisionet mbi të vërtetën, e ilustrojnë mirë këtë qëllim. Në të dyja vendet është dashur më shumë dekada për t’u materializuar përparimi në disa nga lëmit kyçe, më se gjysma e komisioneve të analizuara në këtë punim, e kanë përfunduar punën e tyre në pesë vitet e fundit dhe vlerësimin e të arriturave të tyre duhet marrë vetëm si të përkohshëm.

---

<sup>1</sup> Tentimi për të matur një efekt tillë ka pasur disa vështirësi fundamentale:

- Vetë ideja e “pajtimit” i është nënshtruar interpretimeve dhe përdorimeve të ndryshme. Me këtë term mund të nënkuptohet marrëdhënia në mes të individëve në bashkësitë lokale, marrëdhënia mes qytetarëve të atij shteti, kuptimi në mes të grupeve etnike, politike apo shoqërore në nivelin nacional apo marrëdhënia në mes të qytetarëve të shteteve të ndryshme. Gjithashtu mund të nënkuptoj edhe mungesën e konfliktit apo armiqësisë, por vështruesit tjerë mund të thonë se ai term kërkon edhe diçka më tepër duke përfshirë komunikimin aktiv apo edhe miqësinë.

- Mungojnë kriteret e qarta për përcaktimin e asaj se a është realizuar pajtimi. Njëra mënyrë për të përcaktuar këtë, mund të ishte edhe përmes hulumtimeve të opinionit publike, por është i njohur vetëm një hulumtim i bërë gjatë viteve 2000/2001 në Afrikën Jugore. Hulumtimi ka dhënë një fotografi të përzier: pakica e popullatës së zezë (37 përqind), shumica e të bardhëve (57 përqind), “të ngjyrosurit” (71 përqind) dhe njerëzit me prejardhje aziatike (59 përqind) – besojnë se është arritur pajtimi racor.

- Viktimat mund, as të mos e konsiderojnë pajtimin si qëllim të cilin duhet arritur. Shoqatat e viktimave në shtetet e Amerikës Latine, për shembull, e shikojnë me dyshim “pajtimin”, duke pasur parasysh përdorimin e jo të sinqertë të “pajtimit” nga ana e qeverive të cilat kanë dhënë amnisti për krime serioze.

- Edhe sikur pajtimi të pranohej si qëllimi i dëshiruar prej të gjithë anëtarëve të një shoqërie, edhe pse i definuar si duhet, prapë do të ishte shumë vështirë të izolohej puna e komisionit prej faktorëve tjerë, dhe të përcaktohej përmasa e kontributit të komisioneve. Hulumtimi i qëndrimeve të individëve në shoqërinë e vëzhguar do të mund të ndihmonte në gjetjen e asaj lidhjeje mes tyre. Sipas hulumtimeve në Kili (në dhjetor të vitit 2004) dhe në Sierra Leone (në korrik të vitit 2007) 70 përqind të opinionit në ato dy shtete kanë besuar se komisionet e atjeshme për të vërtetën i kanë kontribuar pajtimin. Mirëpo, në burimet e shumta në të cilat ky punim bazohet, nuk ka referenca për hulumtime të ngjashme të cilat mund të jenë bërë në vende tjera.

## **1. Ofrimi i përshkrimit autentik të lëndimeve të shkaktuara në të kaluarën**

Treguesi i parë i suksesit apo mospushtimit të komisionit mbi të vërtetën, është masa në të cilën arrin të vërtetë faktet, duke përfshirë edhe ato fakte të cilat nuk kanë qenë të njohura për opinionin, faktet mbi shkeljen e të drejtave të njeriut, të edukoj opinionin e gjerë dhe të kufizoj aftësinë e kryerësve të fuqishëm që të mohojnë krimet e veta. Përcaktimi i së vërtetës përmes punës efektive të komisioneve mbi të vërtetën, përpos tjerash, përbëhet edhe prej dhënies së rezultateve mbi shkresat e dhunës dhe përgjegjësisë institucionale, hulumtimit të rasteve të ilustruara, identifikimit të viktimave dhe formimit të vlerësimeve të besueshme për numrin e tyre, kohën dhe territorin ku kanë pësuar.

Shumica e komisioneve mbi të vërtetën kanë pasur sukses në arritjen e këtyre qëllimeve. Në vendet si Kili, El Salvadori, Peru, Sierra Leone dhe Afrika Jugore, hulumtimet e opinionit publik kanë shfaqur miratimin për punën e komisioneve si dhe të rezultateve të tyre.

Gjysma e komisioneve të analizuara këtu (El Salvador, Gana, Peru, Sierra Leone, Afrika Jugore dhe Timori Lindor), me mandate kanë qenë të autorizuar të japin rezultatet mbi përgjegjësinë individuale, si pjesë e përcaktimit të plotë të së vërtetës. Komisionet mbi të vërtetën në Argjentinë, Kili, Guatemalë dhe Maroko, nuk kanë qenë të autorizuar, që në rezultatet e tyre të japin emrat e kryerësve të krimeve të cekura. Brenga në lidhje me drejtësi në proces apo faktorët politik kanë pasur si pasojë mandatin e fokusuar në institucione. Po, në rastet e përmendura, shmangja e dhënies së emrave, nuk i ka bërë jo efektive rezultatet. Përcaktimi i përgjegjësisë së institucioneve ka krijuar një ambient të kënaqshëm për reforma rrënjësore, dhe në rastin e Guatemalës dhe Marokos, ka përfunduar me rezultate të fuqishme mbi shkaqet strukturale dhe ka krijuar një ambient edhe më të favorshëm për reformat e tërësishme.

## **2. Pranimi publik dhe reparacionet simbolike**

Pranimi i plotë, publik dhe i pa rezervë i krimit e ka përcjellë punën e shumicës së komisioneve mbi të vërtetën, të cilat po studiohen në këtë punim, edhe pse gjestet e tilla shpesh herë kanë qenë jo të plota, apo puna e tyre ka qenë e zvarritur. Kërkimet për falje, sidomos nëse bëhen me premtimin e reformave dhe parandalimeve, zakonisht sugjerojnë se qeveria është e gatshme për t'u ballafaquar me rezultatet e komisionit mbi të vërtetën.

Menjëherë pas publikimit të raportit në Kili, kryetari i shtetit ka kërkuar falje për shkeljet e bëra të të drejtave të njeriut. Në Guatemalë është dashur të kalojnë 11 muaj dhe të ndërrohet qeveria, në mënyrë që kryetari i shtetit të kërkojë falje, gjersa në Argjentinë dhe në Kili, vitin e kaluar ka ardhur gjer te publikimi i raportit dhe kërkimi i faljes nga ana e përfaqësuesit të ushtrisë, e cila ka qenë institucioni kyç në historinë e shkeljes së të drejtave njerëzore në të dyja vendet.

Në Peru, Afrikën e Jugut, Guatemalë, Ganë dhe Maroko, disa kryetarë të shteteve kanë pranuar vuajtjet dhe kanë kërkuar falje, megjithatë disa të tjerë nuk e kanë bërë këtë (përfaqësuesit e ushtrisë në Peru, njëri nga ish kryetarët nga periudha e aparteidit në Afrikën e Jugut, përfaqësuesit e ushtrisë në Guatemalë dhe premieri i Marokos). Në El Salvador dhe Sierra Leone nuk ka pasur kërkim falje, as kërkim falje serioze nga ana e zyrtarëve të Indonezisë për krimet e kryera ndaj popullatës së Timorit Lindor.

Para disa komisioneve edhe kryerësit e krimeve kanë pasur rastin të marrin pjesë në dëshmimet publike dhe të pranojnë krimet e veta. Në katër muajt e parë të punës së komisionit në Sierra Leone (prill-gusht 2003), më se 13 përqind nga gjithsejtë 8 000 deklaratat individuale janë iniciuar nga vetë kryerësit e krimeve, dhe një e treta e atyre që janë paraqitur në dëshmimet publike i kanë pranuar krimet e tyre, shpesh herë në mënyrë shumë detajore. Në Timorin Lindor, Programi për pajtim me shoqërinë, me shumë sukses, i iniciuar nga ana e komisionit mbi të vërtetën, ka mundësuar që rreth 1 400 kryes të krimeve pak më të lehta të natyrës politike, të fitojnë imunitetin nga ndjekjet penale, në qoftë se kishin pranuar veprimet e veta dhe kanë kaluar përmes aktit të pajtimit, zakonisht në formë të shërbimit në shoqëri.

Në Afrikën e Jugut dhe Ganë, shumica e kryerësve të krimeve të cekura të cilët janë paraqitur para Komitetit nuk i kanë pranuar krimet e tyre dhe nuk kanë kërkuar falje.

Në Argjentinë, Kili, Afrikën Jugore dhe Maroko, qeveritë kanë bërë tentime domethënëse që vendet e kujtimit ku janë kryer shkeljet e të drejtave të njeriut, të përshkruara në raportet e komisionit, të shndërrohen në vende përkujtimi.

Përparimi në krijimin e vend-përkujtimeve në shumicën e vendeve ka qenë i ngadalshëm.

### **3. Reparacionet materiale**

Pothuaj të gjitha komisionet që janë subjekt i këtij punim, kanë propozuar masat e reparacioneve materiale për viktimat. Në Argjentinë, Kili, Maroko, Afrikën e Jugut dhe Ganë, reparacionet u janë paguar një rrethi të gjerë të marrësve individual. Disa grupe të viktimave kanë marrë reparacione në Guatemalë dhe Timorin Lindor. Në Sierra Leone dhe Peru pesë vite pas mbarimit të punës së komisioneve, qeveritë ende nuk kanë qenë në gjendje të fillojnë me pagesën e reparacioneve individuale, edhe pse ishin vendosur procedurat për pagesat. Në El Salvador, reparacionet nuk u paguan asnjëherë.

Shumica e vendeve, ku kanë vepruar komisionet, kanë qenë ekonomikisht të dobëta, gjë që ka bërë të vështirë sigurimin e reparacioneve, edhe sikur qeveritë të ishin më të gatshme në vullnetin e tyre për të përmirësuar gjendjen e viktimave. Sierra Leone dhe Guatemala, për shembull, janë ndër shtetet më të varfra në botë, gjersa situata në Timorin Lindor është për një nuancë më e mire. Pos kësaj, vendet e varfra kanë qenë edhe arena të luftërave shumë brutale dhe të gjata, gjë që ka për pasojë numrin e madh të viktimave që kanë të drejtë në reparacion. Në fakt edhe atje ku qeveritë kanë dhënë reparacione individuale materiale, shumat që u janë paguar viktimave kanë qenë shumë modeste, me përjashtim të reparacioneve të paguara në Argjentinë, Kili dhe Maroko.

Disa vende (Guatemala, Maroko dhe Peru) kanë implementuar edhe masat e reparacioneve kolektive (reparacione për bashkësitë), nga ato fusha të cilat kanë qenë të përfshira me shkeljet e të drejtave njerëzore gjatë periudhave të cilat janë hulumtuar nga ana e komisioneve mbi të vërtetën. Këto masa përfshijnë programe për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe kulturor.

#### 4. Ndjekja penale

Ekzistojnë dy aspekte të ndryshme të marrëdhënieve mes komisioneve mbi të vërtetën dhe ndjekjeve penale në vendet të cilat janë hulumtuar në këtë studim. Njëri është sa i përket potencialit të komisionit për të ndihmuar në inicimin e ndjekjeve penale në periudhën në të cilën ato ende nuk kanë filluar, gjersa i dyti është përkitazi me kontributin e komisioneve për gjykimet, atëherë kur gjyqësia veç ka filluar të merret me trashëgiminë shumë të përhapur të shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Në vendet e analizuara këtu, para vendosjes së komisioneve mbi të vërtetën nuk ka pasur gjykime për shkeljen e të drejtave të njeriut para gjykatave *vendore*. (Panelet “hibride“ për krime të luftës, të sponsoruara nga Kombet e Bashkuara, kanë ekzistuar në Sierra Leona dhe Timorin Lindor vetëm në momentin kur komisionet mbi të vërtetën kanë filluar të veprojnë në ato vende.) Në shumë vende, strukturat dhe individët përgjegjës për shkeljet nga e kaluara, kanë vazhduar të kenë rol në jetën politike, ose kanë qenë të përjetuar si tejet të fuqishëm për t’iu nënshtruar procedurës së hetimit penal. Në këto kushte, komisionet mbi të vërtetën nuk kanë mundur menjëherë të krijojnë hapësirë për ndjekjet gjyqësore. Në disa vende tjera (Afrika e Jugut dhe Sierra Leone) mungesa e ndjekjes penale ka paraqitur preferencat e fuqishme të qeverive të reja ndaj pajtimit, për të cilat kanë konsideruar se nuk janë kompatible me përdorimin e gjerë të mekanizmave të ndjekjeve gjyqësore.

Kur fuqitë që ishin përgjegjëse për shkeljet nga e kaluara, humbën ndikimin e vet në elitat politike apo aparatit e sigurimit në Argjentinë, Kili dhe Peru, informatat të mbledhura nga komisionet mbi të vërtetën kanë qenë të shfrytëzuara nga ana e prokurorëve dhe gjykatave. Komisioni mbi të vërtetën në Sierra Leone nuk e ka dhënë kontributin e drejtpërdrejtë për ndjekjet gjyqësore para tribunalit “hibrid“ për krime të luftës, gjersa të ashtuquajturat panele për krime serioze në Timorin Lindor kanë pasur mundësinë e zhvillimit dhe ngritjes së rasteve dhe shfrytëzimin dokumentacionit të komisionit kundër individëve, të cilët pa sukses kanë aplikuar për imunitet para komisionit.

Komisionet mbi të vërtetën në El Salvador, Ganë dhe Maroko janë përmbajtur nga rekomandimet e ndjekjeve gjyqësore. Kanë konstatuar se balansi i fuqisë apo dobësisë së gjyqësisë, i bënë këto ndjekje penale pak të mundshme në të ardhmen e afërt.

## 5. Zgjidhja e rasteve të të zhdukurve me dhunë

Komisionet mbi të vërtetën në Maroko, Peru dhe Afrikën e Jugut, në punën e tyre kanë përfshirë edhe zbulimin e fatit të personave të zhdukur. Komisionet më së shpeshti kanë pasur një qëllim më të kufizuar - mbledhjen e të dhënave për rastet e të zhdukurve dhe krijimin e një regjistri të bazuar në këto të dhëna, i cili mund të shërbej si bazë për punën e mëtejme të agjensioneve të specializuara.

Në të shumtën e rasteve të të zhdukurve, të cilat janë paraqitur te komisionet e Afrikës së Jugut dhe Marokos, komisionet kanë zbuluar fatin e viktimave dhe kanë zbuluar vendet ku janë varrosur. Komisioni në Maroko ka zbardhur fatin e 742 personave të cilët janë lajmëruar si viktima të zhdukjes së dhunshme. Kanë mbetur 66 raste të pazbardhura ende. Komisioni i Afrikës së Jugut ka pranuar më se 1.500 deklarata rreth viktimave të zhdukura me dhunë, dhe pas mbarimit të punës së komisionit, mbetën edhe 477 raste të pazgjdhura. Në Peru dhe Guatemalë është bërë një punë e rëndësishme në eshumimin dhe identifikimin, edhe pse shumica e rasteve ende nuk janë zbardhur. Në Argjentinë, Kili, El Salvador dhe në Timorin Lindor nuk ka pasur përparim më të madh. Numri i rasteve të personave të zhdukur në Ganë dhe Sierra Leone është relativisht i vogël, dhe kjo nuk ka qenë prioritet në punën e këtyre dy komisioneve mbi të vërtetën.

## 6. Reformat institucionale dhe demokratizimi

Komisionet mbi të vërtetën në praktikë kanë pasur rol në nxitjen e reformave institucionale, i cili ka qenë më i vogël se roli që e kanë pasur në gjenerimin e ndryshimeve të së drejtës tranzicionale- në fushën e përcaktimit të së vërtetës, ndjekjeve penale dhe reparacioneve. Pothuaj të gjitha reformat institucionale formësohen gjatë negociatave të cilat e përcjellin tranzicionin, gjersa komisionet mbi të vërtetën krijohen më vonë.

Sipas rishikimit të përvojave në vendet e ndryshme, disa komisione mbi të vërtetën kanë kontribuar në procesin e reformave institucionale, por shpeshherë është shumë vështirë të përcaktohet lidhja e drejtpërdrejtë e shkakut dhe pasojës. Instancat në të cilat raportet e komisioneve mbi të vërtetën janë shfaqur në reformat institucionale, kanë qenë të rralla (ndryshimet në personelin gjyqësor dhe ushtarak në El Salvador, i ashtuquajturit *impugnaciones* në Argjentinë, miratimi i ligjit në Peru i cili kërkon nga zyrtarët ushtarak që të mos i binden atyre urdhrave që janë kundër standardeve të të drejtave njerëzore, vendosja e komisionit për të drejtat e njeriut në Sierra Leone).

Mirëpo, mund të pohohet bindshëm se komisionet mbi të vërtetën kanë formësuar reformat, ashtu që kanë nxjerr në shesh përgjegjësinë e institucioneve kyçe për krime në të kaluarën. Supozohet se një demaskim i tillë i përgjegjësisë krijon trysni në institucione që të reformohen, në mënyrë që të rikthejnë legjitimitetin. Shembujt e ndryshimeve hap pas hapi në ushtrinë e Argjentinës dhe Kilit, mund të përdoren në favor të këtij pohimi.

Kur hulumtohen përmasat e demokratizimit në shtetet e vëzhguara, patjetër duhet të marrim parasysh se shumica e tyre ka një histori të re jo të largët të konfliktit të armatosur, traditë demokratike të vogël apo kurrfarë dhe nivel të lartë të varfërisë. Në këto kushte, përparimi i cili është bërë në shumicën e këtyre vendeve është i rëndësishëm. Dy ekspertë eminent për demokratizim, kanë deklaruar së voni: "Po të thoshte dikush në vitin 1980 se El Salvadori dhe Guatemala do të bëhen demokraci, do të dyshohej se ai është në delirium"<sup>2</sup>. Në mënyrë të njëjtë kjo është e aplikueshme edhe në vendet siç janë Sierra Leone, Afrika e Jugut dhe Gana. Të gjitha këto janë bërë demokraci funksionale pas mbarimit të konflikteve apo qeverive autoritare, edhe përkundër varfërisë së madhe të përhapur në tërë vendin.

## **Përfundimi**

Në kuadër të shqyrtimit të kontributit potencial të KOMRA-s për të vërtetën dhe drejtësinë në vendet e ish-Jugosllavisë, ekzistojnë leksione të rëndësishme të cilat mund të nxirren nga përvoja e dymbëdhjetë komisioneve mbi të vërtetën në këtë punim. Shumica e këtyre komisioneve kanë qenë të suksesshme në përcaktimin e përshkrimit autentik të shkeljeve të kryera në të kaluarën. Sipas rregullit, përshkrimi i tillë ka qenë i përkrahur plotësisht në shoqërinë e dhënë dhe kornizat ndërkombëtare. Në këtë kuptim, komisionet kanë qenë të suksesshme në përgënjeshttrimin e tregimeve të shtrembëruara nga e kaluara. Efekti i tillë është tregues se komisioni i ardhshëm mbi të vërtetën në territorin e ish-Jugosllavisë mund të dobësojë, në mënyrë të konsiderueshme, shfaqjet e njëanshme nga e kaluara, të cilat tani për tani janë dominuese, dhe të mundësojë krijimin e kornizës të mbushur me respektin e ndërsjellët, për shoqëritë- sidomos për viktimat- ku konflikti do të kuptohej më mirë dhe do vlerësohej çmimi i konfliktit i shprehur me vuajtjet njerëzore. Analiza gjithëpërfshirëse dhe autentike e shkresave mbi dhunën dhe përgjegjësinë institucionale, mund të sjellë gjer te eliminimi i pengesave të mëdha për normalizimin e marrëdhënieve në mes të shteteve dhe popujve të këtij rajoni.

Komisionet kanë qenë në gjendje të japin vlerësime të sakta të numrit të përgjithshëm të viktimave, e zakonisht edhe të përgatisin edhe listat e viktimave individuale. Në vendet ku dhuna është përjetuar në masa të stërmëdha, ato lista kanë qenë jo të plota, ose janë përcjellur me projeksione statistikore. Kështu mund të ndodh edhe me rastin e rajonit të ish-Jugosllavisë. Mirëpo, komisioni i planifikuar rajonal, do të mund të mbështetej në listat ekzistuese të Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të kuq dhe organizatave kredibile për të drejtat e njeriut në rajon, si dhe në deklaratat më të reja të viktimave dhe në burimet tjera, me qëllimin realistik të ofrimit të përpilimit të listave kompetente dhe vlerësimeve të besueshme shkencore.

Edhe një lëmi, në të cilën komisionet mbi të vërtetën kanë qenë goxha të suksesshme, janë pranimet zyrtare dhe gjestet për kërkim falje për shkeljet e kryera në të kaluarën.

---

<sup>2</sup> Scott Mainwaring dhe Frances Hagopian, "Introduction: The Third Wave of Democratization in Latin America", në Frances Hagopian & Scott Mainwaring, *The Third Wave of Democratization in Latin America: Advances and Setbacks* (Cambridge University Press, 2005. ), str. 11



Çështja e kërimit të faljes në ish- Jugosllavi ka qenë shumë kontroverse. Disa ish kryetarë dhe kryetarë të tashëm të vendeve në rajon kanë kërkuar falje në emër të shtetit që përfaqësojnë, por shumica e këtyre kërkim-faljeve janë përjetuar si jo mjaft të sinqerta. Ajo që është më me rëndësi është fakti se këto deklarata nuk janë dhënë në kontekstin domethënës, sepse nuk janë paraprirë nga tentimet serioze të shteteve relevante që të përgjigjen në shkeljet e kryera në të kaluarën përmes procesit të përcaktimit të të vërtetës, ndjekjeve penale apo reparacioneve ligjore. Komisioni kredibil mbi të vërtetën, të cilën do ta themelonin qeveritë e shteteve në rajon, dhe e cila do të mbështetej në përkrahjen e tyre, do të përfaqësonte një mundim të tillë dhe do të ofronte kontekst domethënës për dhënien e kërkim- faljes dhe mënyrat tjera të reparacioneve simbolike.

Shumica e komisioneve mbi të vërtetën kanë qenë efektive në sigurimin e platformës për viktimat, në mënyrë që të tregojnë tregimet e tyre dhe ta rikthejnë dinjitetin e tyre. Kontributi i komisionit rajonal mbi të vërtetën në ish- Jugosllavi, mund të jetë shumë i rëndësishëm sa i përket kësaj çështjeje, se një komision i tillë do të ofronte rastin e parë dhe unik, viktimave të një shteti, vendi apo grupi etnik, që të shihen dhe dëgjohen nga pjesëtarët e grupeve tjera etnike dhe opinionit publik të vendeve tjera në rajon. Për herë të parë që nga përfundimi i konfliktit, do të krijohet hapësira për rindërtimin e solidaritetit me viktimat e grupeve tjera.

Gjykimet në ish- Jugosllavi po mbahen për shumë vite me radhë, e cila e ndryshon shumë kontekstin nga të gjitha vendet që janë hulumtuar në këtë punim. Ky dallim paraqet përparësi për vendet e ish- Jugosllavisë. Çështja e kontributit të mundshëm të komisionit për inicimin e ndjekjeve penale në rajon, në të vërtetë as që parashtrohet. Në situatën në të cilën gjykimet veç kanë filluar, komisioni mbi të vërtetën me siguri do të jap kontribut të rëndësishëm, sikur që tregojnë rastet e Argjentinës, Kilit dhe Perusë.

Nuk ka shumë leksione të cilat mund të nxirren nga përvojat e kaluara mbi efektet e mundshme të komisionit rajonal në kërkimin e personave të zhdukur në vendet e ish- Jugosllavisë. Ato vende tashmë veç i kanë komisionet për persona të zhdukur, ku asnjëra nga shtetet e analizuara këtu nuk e ka pasur. Ekzistojnë baza që të konkludohet se të arriturat e rëndësishme të komisioneve mbi të vërtetën në Maroko dhe në Afrikën Jugore janë pjesërisht pasojë e publicitetit i cili ka përcjellë punën e tyre, dhe se individët nga ish-Jugosllavia, të cilët kanë informata mbi lokacionet e varrezave masive, gjithashtu mund të nxiten të bashkëpunojnë me komisionin mbi të vërtetën dhe t'i japin ato informata. Në mungesë të çfarëdo hulumtimi sistematik mbi këtë çështje, konkludimi i tillë mbetet në kornizën e hipotezës.

Ashtu siç shihet nga ky studim, përparimi në sigurimin e reparacioneve materiale nuk ka qenë i njëjtë në të gjitha vendet. Fuqia ekonomike e shteteve të ish- Jugosllavisë, i bënë të krahasueshme me Argjentinën, Kilin dhe Marokon, ku shumica e viktimave kanë marrë reparacione individuale në shumë të konsiderueshme. Nga ana tjetër, numri i viktimave mund të krahasohet me numrin e viktimave në vendet ku ka pasur vështirësi gjatë sigurimit të reparacioneve individuale apo materiale. Në secilin rast, komisioni rajonal do të ishte në pozitë unike që t'i kontribuoj masave të reparacionit me krijimin e listës gjithëpërfshirëse të viktimave. Listat, vetvetiu, do të eliminonin mundësinë e vazhimit të

masave të tashme të reparacionit, të cilat kryesisht janë të bazuara në regjistrimin apo largimin e viktimave nga lista, varësisht nga përkatësia e tyre etnike.

Marrëdhënia në mes të komisionit mbi të vërtetën dhe reformave të institucioneve, në shumicën e vendeve që janë analizuar këtu, nuk ka qenë shumë i qartë. Një përvojë e këtillë kërkon kujdes në shqyrtimin e kontributit të mundshëm të komisionit rajonal gjatë reformave.

Në përgjithësi, efekti i komisioneve mbi të vërtetën në Argjentinë, Kili, El Salvador, Ganë, Guatemalë, Maroko, Peru, Sierra Leone, Afrikën Jugore dhe Timorin Lindor tregojnë se efikasiteti i komisionit rajonal për vendet e ish- Jugosllavisë mund të varet shumë nga kreativiteti dhe devotshmëria dhe përkushtimi i vetë komisionit, përkrahja e qeverive por edhe nga kapaciteti i organizatave të shoqërisë civile për krijimin e lidhjeve të gjëra shoqërore. Edhe pse përvojat e deri tanishme me komisionet nuk e garantojnë suksesin e komisionit të ardhshëm rajonal, ato as nuk tregojnë se nuk duhet të presim kontributin e saj të suksesshëm dhe afatgjatë.